

20251573433

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 37 të Ligjit për zbatimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 254/24 dhe 151/25), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 29 korrik 2025, miratoi

**PROGRAM PËR PLOTËSIMIN E PROGRAMIT PËR ZBATIMIN E FONDIT INTERVENUES PËR
BUJQËSINË PËR VITIN 2025**

I

Në Programin për zbatimin e Fondit Intervenues për bujqësinë për vitin 2025 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 66/25), në pjesën II, në tabelë, pas nënmasës 1.1., shtohet një nënmasë e re 1.2., e cila ka këtë përmbajtje:

1.2.	Mbështetje financiare për verën e prodhuar	1. Përfitues të kësaj nënmasë janë prodhuesit vendorë të verës, të regjistruar në Regjistrin e Prodhuesve të Verës. 2. Sasia maksimale e verës së prodhuar që është e pranueshme për mbështetje financiare është deri në 4.000.000 litra verë për përfitues. 3. Lartësia e mbështetjes financiare është 2 denarë për litër verë të prodhuar nga sasi të blera të rrushit nga rekolta e vitit 2024.
------	--	--

II

Në pjesën III shtohet një paragraf i ri 2, i cili ka këtë përmbajtje:

"Mbështetja financiare nga pjesa II për nënmasën 1.2 'Mbështetje financiare për verën e prodhuar' nga ky program do të realizohet në bazë të të dhënave për verën e prodhuar nga sasi të

e blera të rrushit për prodhim vere nga rekolta e vitit 2024, të cilat Agjencisë ia dorëzon Inspektorati Shtetëror për Bujqësi, më së voni deri më 31 gusht 2025.”

III

Ky program hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 50-7182/4
29 Korrik 2025
Shkup

Kryetar i Qeverisë
së Republikës së Maqedonisë së Veriut
prof.d-r Hristijan Mickoski, n.p